



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLI

V E N D I M
K.P.P. 116/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.03.2019 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Avduli” sh.p.k., “OB Konstruksion” sh.p.k., “Spektri” sh.p.k., “Vllaznia Ndërtimi I.S” sh.p.k., dhe “Llazo” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-94207-11-14-2018, me objekt, “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Anastas Laska”, fshati Libofshë, Nj.A. Libofshë”, me fond limit 26.533.556 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 17.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues:

“Colombo” sh.p.k.
Lagja “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Vangjel Rrushku”, Fier

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier

Subjekte të Interesuar:

“Llazo” sh.p.k.
Autostrada LU-FR, Km7, Pushimi i Shoferit, Lushnje 9001

“Vllaznia Ndërtimi I.S” sh.p.k.
Lagja “Pjetër Budi”, Burrel

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.11.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-94207-11-14-2018, me objekt, “Rikonstruktion i shkollës 9 vjeçare “Anastas Laska”, fshati Libofshë, Nj.A. Libofshë”, me fond limit 26.533.556 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 17.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 17.12.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 03.01.2019 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--|-----------------------------------|
| 1. “Avduli” sh.p.k. | 17.975.861 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & “O.B Konstruksion” sh.p.k. | 18.258.316 lekë, kualifikuar |
| 3. “Spektri” sh.p.k. | 18.569.458,3 lekë, kualifikuar |
| 4. “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. | 20.311.505 lekë, kualifikuar |
| 5. “Llazo” sh.p.k. | 20.374.961 lekë, kualifikuar |
| 6. “Colombo” sh.p.k. | 20.600.263 lekë, kualifikuar |
| 7. “Sark” sh.p.k. | 20.939.940,17 lekë, kualifikuar |
| 8. “Shendelli” sh.p.k. | 21.500.000 lekë, kualifikuar |
| 9. BOE “K.M.K” sh.p.k. & “Sinder – AB” sh.p.k. & “Sardo” sh.p.k. | 22.301.443 lekë, skualifikuar |
| 10. “B-93” sh.p.k. | 23.044.753 lekë, kualifikuar |
| 11. BOE “Jogi” sh.p.k. & “Ngraçan 1934” sh.p.k. | 23.370.213 lekë, kualifikuar |
| 12. “Lala” sh.p.k. | 25.196.408,39 lekë, kualifikuar |
| 13. “Elda-VL” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 14. “Kevin Konstruksion” sh.p.k. | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.4. Operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. në datën 09.01.2019 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Avduli” sh.p.k., “OB Konstruksion” sh.p.k., “Spektri” sh.p.k., “Vllaznia Ndërtimi I.S” sh.p.k., dhe “Llazo” sh.p.k., me pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

Nga njoftimi elektronik shikohet se nga ana e Autoritetit Kontraktor (KVO) Bashkia Fier janë kualifikuar shoqerite Avduli shpk, OB Konstruksion, Spektri, Vllaznia Ndertim IS, Llazo shpk per te cilat shoqeria Colombo shpk shpreh rezervat e veta ne lidhje me kualifikimin e ketyre shoqerive nga ana e Autoritetit Kontraktor ne kundërshtim me dokumentat standarte te Prokurimit per kete objekt te kerkuar nga ana e Autoritetit. Verejme se nga ana e KVO-se eshte bere nje vleresim shabllon pa u thelluar dhe verifikuar me seriozitet per permbushjen e kriterëve te dst nga ana e operatoreve te mesiperm. Shoqeria jone i kerkon Autoritetit Kontraktor rishikimin e kualifikimit te shoqerive duke zbatuar me korrektesi dst pasi operatore ekonomike te permendur me larte ne baze te informacioneve qe ne disponojme ne lidhje me dokumentacionin e ketyre shoqerive, kemi pretendime se keto shoqeri nuk i plotesojne kriteret standarte te tenderit.

Shoqeria “Avduli shpk”

Dst 2.3 Kapacitet Teknike. 2.3/2 Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

- *Inxhinier ndertimi I(nje)*
- *Arkitekt I (nje)*

Pika b: b- Stafii drejtues i shoqerise (ing. ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne license e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Shoqeria "Avduli shpk" nuk disponon Arkitekt ne license sipas kerkeses se dst per periudhen Janar-Shtator 2018. Referuar vendimit te KPP nr. 726/2018 date 25/10/2018 Inxhinieri Ndertimit Altin Ramolli rezulton i dypunesuar ne shoqerine "Avduli shpk" si dhe shoqerine "Agi Kons" si dhe Inxhiniere Brunilda Avduli eshte e punesuar prane Fakultetit te Inxhinierise se Ndertimit me kohe te plote si dhe ne shoqerine "Avduli" shpk me kohe te plote cka bie ndesh me kodin e punes i Republikes se Shqiperise i ndryshuar pasi edhe fizikisht eshte e pamundur te kryej 2 (dy) detyra si prane njeres shoqeri/institucion ashtu edhe prane tjetres. Referuar kontrates se mjekut M.A paraqitur nga "Avduli shpk" nuk mund te konsiderohet e vlefshme per arsye se eshte ne kundersizim me VKM nr 399. date 3.5.2017 dhe nenit 21 te ligjit 7961 date 12.07.1995 (i ndryshuar).

Dst 2.3/5 Disponimi ose mundesia e sigurte e disponimit ne pajisjet/kapacitetet e meposhtme teknike qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates

Pompe suvatimi cope 2(dy)

Depozite uji (5000 litra) cope 2(dy)

Skela metalike suvatimi 3000m2

Per keto pajisje shoqeria "Avduli" shpk ka paraqitur fatura tatimore te ndryshme te cilat nga ana juaj duhet te ishin verifikuar pasi nga informacionet qe kemi rezultojne te jene jo te sakta.

Dst 2.3/8 Analiza e Cmimeve. Nga informacionet qe kemi rezultojne se nga ana e kesaj shoqerie hartimi i ketyre Analiza te cmimeve ka deformime te medha ne pershkrime dhe saktessim te cmimeve per zerat e preventivit duke i konsideruar nga ana jone jo sipas standartit. I kerkojme KVO se Autoritetit Kontraktor s'kualifikimin e kesaj shoqerie per mosplotesimin e Dst sipas kerkesave.

Dst 2.3/3 Shoqeria duhet te kete ne listepagese ose me kontrate pune specialiste te certifikuar sipas profesioneve si me poshte:

Muratore 8(tete)

Hekurkthyes 2(dy)

Nga informacionet qe kemi rezultojne se nga ana e kesaj shoqerie punonjesi E.R i paraqitur si hekurkthyes ne listepagesat e shoqerise "Avduli shpk" figuron si saldatore, punonjesi A.A I paraqitur si hekurkthyes ne listepagesat e shoqerise "Avduli shpk" figuron si roje dhe E.H I paraqitur si muratore ne listepagesat e shoqerise "Avduli shpk" figuron si shofer. Gjithashtu dhe nje nga muraret e kesaj shoqerie nuk figuron ne listepagesen per muajin Janar 2018-Shkurt 2018 gje qe bie ne kundersizim me kriteret e dst. Shoqeria Avduli shpk nuk ploteson kerkesat e mesiperme per kualifikim.

Shoqeria OB Konstruksion

2.3/2 Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

Inxhinier ndertimi I (nje)

Arkitekt I (nje)

Pika b-Stafii drejtues i shoqerise (ing. ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018

Dst 2.3/4 Nje punesim mesatar per periudhen Janar-Shtator 2018, i te pakten 50 personave me kohe te plote pune, duke perfshire stafin e perhershem. Shoqeria OB Konstruksion nuk ploteson kerkesat e mesiperme per kualifikim.

Shoqeria Spektri shpk

2.3/2 Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

- *Inxhinier ndertimi 1 (një)*
- *Arkitekt 1 (nje)*

Pika b-Stafi drejtues i shoqerise (ing. ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne license e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Nga informacionet tona rezulton se shoqeria "Spektri shpk" nuk ka si drejtues teknik minimalisht 1 arkitekt, shoqeruar me kontrate pune, diplome dhe CV kjo ne kundershkrim me kriterin e dhene ne dokumentat e tenderit. Dst 2.2 pika 2. Kopje te vertetuar te bilanceve te vitit 2016 dhe 2017 te paraqitura prane Autoriteteve perkatese dhe i konfirmuar. Sipas informacioneve pasqyrat financiare te kesaj shoqerie jane jo te plota dhe mungon akt ekspertiza e ekspertit kontabel.

Dst 2.3/2 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete 1 nje (Mjek) nderrmarje te punesuar, ne baze te paragrafit 12/2 te VKM Nr.692, date 06.11.2003. Nga informacionet tona Mjeku i kesaj shoqerie nuk figuron ne listepagesen e muajit Shtator 2018. Shoqeria Spektri shpk nuk ploteson kerkesen e mesiperme.

Shoqeria Vllaznia Ndertim I.S

2.3/2 Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

- *Inxhinier ndertimi 1 (një)*
- *Arkitekt 1 (nje)*

Pika b- Stafi drejtues i shoqerise (ing. ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Sipas informacioneve ky kriter nuk plotesohet plotesisht nga ana e operatorit ekonomik, ne listepagesat e sigurimeve shoqerore per periudhen Janar-Shtator 2018, punonjesi me profesion "Arkitekt" nuk rezulton ne listepagesen per majin Janar, Shkurt dhe Mars 2018, pra ky kriter nuk eshte ne perputhje me DST-te e kerkuara nga ana e autoriteit kontraktor.

Dst 2.3/4 Nje punesim mesatar per periudhen Janar-Shtator 2018, i te pakten 50 personave me kohe te plote pune, duke perfshire stafin e perhershem. Operatori ekonomike nuk ka paraqitur listepagesat e sigurimeve shoqerore te punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi (formularet E-sig025 a) per periudhen Korrik 2018 - Gusht2018.

Shoqeria Vllaznia Ndertim I,S nuk ploteson kerkesat e mesiperme per kualifikim.

Shoqeria Llazo shpk

Dst 2.3/2 Shoqeria duhet te kete ne stafin e tij drejtues

- *Inxhinier ndertimi 1 (nje)*
- *Arkitekt 1 (nje)*

Pika b-Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018.

Nga informacionet tona rezulton se shoqëria “Llazo” sh.p.k. nuk ka si drejtues teknik minimalisht 1 arkitekt, shoqëruar me kontratë pune, diplomë dhe CV kjo në kundërshtim me kriterin e dhënë në dokumentat e tenderit.

Dst 2.3/8 Analiza e Cmimeve

Nga informacionet qe kemi rezultojne se nga ana e kesaj shoqerie nuk jane paraqitur Analizat e cmimeve. Shoqeria Llazo shpk nuk ploteson kerkesat e mesiperme per kualifikim. Per sa mesiperme i kerkojme Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier (KVO) skualifikim e shoqerive te mesiperme pasi kualifikimi i tyre eshte i pambeshtetur ne dst dhe ligjin per Prokurimet Publike.

Kerkojme: 1-S'kualifikimin e operatoreve ekonomike “Avduli shpk”, “O. B Konstruktion”, “Spektri”, “Vllaznia Ndertimi IS”, “Llazo” shpk. 2-Shpalljen fitues te operatorit ekonomik

"Colombo shpk" si oferte e sukseshme e cila ploteson te gjitha kerkesat e dst dhe si oferta me ekonomike.

II.5. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit në datën 15.01.2019, me anë të shkresës nr.171/4 prot., i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor argumenton:

"[...]

Komisioni per Shqyrtimin e Ankeses pasi shqyrtoi te gjithë dokumentat e vena ne dispozicion nga Njesia e prokurimit si: dokumentat e hedhura ne sistem prej operatoreve ekonomike, DST per kete procedure e cdo dokument tjetër te nevojshëm, i ka komunikuar Kryetarit vendimin si me poshte: Te mos e marre ne shqyrtim ankesen Tuaj per arsvet si me poshte:

Ne faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimit Publik rezulton qe subjekti "Colombo" shpk eshte perjashtuar nga prokurimet publike per nje periudhe 2-vjecare me vendim te App-se. Gjithashtu rezulton qe operatori ekonomik eshte perjashtuar para dates 09.01.2019 date ne te cilen ka paraqitur dhe ankesen per objektin e mesiperm te prokurimit zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier. Per kete arsye Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses kontrolloi faqen zyrtare te App-se dhe shkarkoi vendimin Nr.1. date 07.01.2019, ku Agjencia e Prokurimit Publik ka vendosur te perjashtoje 2 (dy) vjet e gjashte muaj operatorin ekonomik "Colombo" shpk me NIPTJ82916489E, nga pjesemarrja ne procedurat e prokurimit publik, duke filluar nga hyrja ne fuqi e ketij vendimi, pasi ka vleresuar si rrethane renduese faktin qe operatori ekonomik "Colombo" shpk eshte shpallur fitues ne kete procedure prokurimi dhe ka perfituruar fonde publike. Nisur nga sa me siper, KSHA nuk e shqyrtoi ankesen e ardhur nga operatori ekonomik "Colombo" shpk pasi ky operator ekonomik me statusin i perjashtuar nga Agjencia e Prokurimeve Publike nuk mund te realizoje kerkesat e parashtruara ne ankesen e tij, konkretisht pretendimin per shpalljen fitues te tij si oferte e sukseshme e cila ploteson te gjitha kerkesat per procedure "Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare (Anastas Laska fshati Libofshe, NJ.A Libofshe Fier", pasi shqyrtimi apo jo i kesaj ankese nuk i jep te drejten ketij operatori te lidhe kontrata publike per periudhen e siperpermendur.

II.6. Në datën 21.01.2019 operatori ekonomik "Colombo" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 858/1 prot., datë 31.01.2019, protokolluar me tonën në datën 04.02.2019, me objekt "Informacion", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Llazo” sh.p.k. me arsyetimin se “...Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Nga informacionet tona rezulton se shoqëria “Llazo” sh.p.k. nuk ka si drejtues teknik minimalisht 1 arkitekt, shoqëruar me kontratë pune, diplomë dhe CV kjo në kundërshtim me kriterin e dhënë në dokumentat e tenderit...”; për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. me arsyetimin se “Pika b- Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Sipas informacioneve ky kriter nuk plotesohet plotesisht nga ana e operatorit ekonomik, ne listepagesat e sigurimeve shoqerore per periudhen Janar 2018-Shtator 2018, punonjesi me profesion "Arkitekt" nuk rezulton ne listepagesen per majin Janar, Shkurt dhe Mars 2018, pra ky kriter nuk eshte ne perputhje me DST-te e kerkuara nga ana e autoriteit kontraktor.”; dhe për skualifikimin e operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. me arsyetimin se “Pika b-Stafi drejtues i shoqerise (ing. ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknik ne license e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar-Shtator 2018. Nga informacionet tona rezulton se shoqëria "Spektri shpk" nuk ka si drejtues teknik minimalisht 1 arkitekt, shoqëruar me kontrate pune, diplome dhe CV kjo ne kundërshtim me kriterin e dhene ne dokumentat e tenderit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3/2 Shoqëria duhet te kete ne stafin e tij drejtues:

- Inxhinier ndertimi 1(nje)
- Arkitekt 1(nje)

Si dhe te kene ne stafin e tij, si me poshte :

- Teknike ndertimi 2 (dy)

- a) Te gjithë punonjesit e kerkuar me siper sipas pikes 2.3/2 te jene te shoqëruar me diplome, kontrata pune.
- b) Stafi drejtues i shoqerise (ing.ndertimi dhe arkitekt) duhet te jene drejtues teknike ne licensen e shoqerise si dhe ne listepagesat per periudhen Janar –Shtator 2018
- c) Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori i shoqerise pjesemarrëse ne kete prokurim, qe stafi i inxhinierëve, te kerkuar me siper, jane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate dhe nuk jane te angazhuar ne kontrata te tjera.
- d) Deklarate nga administratori i shoqerise per listen e stafit qe do te drejtoje punimet, ku te cilesohen detyra e secilit.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatorët ekonomikë “Llazo” sh.p.k., ”; “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. dhe ”Spektri” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se këta të fundit kanë paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik "Llazo" sh.p.k.

- Deklaratë e shoqërisë ku paraqiten emrat e drejtuesve teknikë të cilët do të drejtojnë punimet.
- Licencën Profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtim zbatimit, në emër të shoqërisë "Llazo" sh.p.k.
- Kontratën e punës nr.rep. 1133 nr.kol. 481/3, datë 30.08.2018 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë "Llazo" sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. D.K me profesion arkitekt-drejtues teknik.
- Diplomë nr.122, "Master i Shkencave në Arkitekturë", në emër të Z.D.K, lëshuar në datë 23.11.2017 nga Universiteti Privat Albanian University.
- Listëpagesat e shoqërisë "Llazo" sh.p.k. për periudhën Janar-Shtator 2018.

Operatori ekonomik "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k.

- Deklaratë e shoqërisë ku paraqiten emrat e drejtuesve teknikë të cilët do të drejtojnë punimet.
- Licencën Profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtim zbatimit, në emër të shoqërisë "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k.
- Kontratën e punës nr.rep. 1322 nr.kol. 563, datë 06.12.2017 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k. dhe punëmarrësit Znj. B.S me profesion arkitekt-drejtues teknik.
- Diplomë nr.3255, dega "Arkitekture", në emër të Znj.B.S, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.
- Listëpagesat e shoqërisë "Vllaznia Ndërtim I.S" sh.p.k. për periudhën Janar-Shtator 2018.

Operatori ekonomik "Spektri" sh.p.k.

- Deklaratë e shoqërisë ku paraqiten emrat e drejtuesve teknikë të cilët do të drejtojnë punimet.
- Licencën Profesionale për ushtrimin e veprimtarisë së ndërtim zbatimit, në emër të shoqërisë "Spektri" sh.p.k.
- Kontratën e punës nr.rep. 2106 nr.kol. 925, datë 21.07.2018 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë "Spektri" sh.p.k. dhe punëmarrësit Znj. M.M me profesion arkitekt-drejtues teknik.
- Diplomë, "Master i Shkencave në Arkitekturë dhe Dizajn Urban", në emër të Znj.M.M, lëshuar në datë 31.10.2011 nga Universiteti Privat Polis.
- Listëpagesat e shoqërisë "Spektri" sh.p.k. për periudhën Janar-Shtator 2018.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.4. Në nenin 26 *“Kontratat për punë publike”*, pika 5, e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar parashikohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.

ç) Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit. [...]

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të vërtetojnë së kanë në stafin e tyre një inxhinier ndërtimi dhe një arkitekt, të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar – Shtator 2018. Gjithashtu, operatorët ekonomik për punonjësit e mësipërm duhet të paraqesin kontratën e punës, diplomën dhe një deklaratë që këta punonjës nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

Sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimes, se operatori ekonomik “Llazo” sh.p.k. nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për një arkitekt, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Llazo” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm. Konkretisht, nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni konstatohet se, operatori ekonomik “Llazo” sh.p.k., ka deklaruar se ka në stafin e

tij të punësuar arkitektin Z.D.K., ku nga verifikimi ky i fundit figuron në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, dhe për të cilin është paraqitur dokumentacioni i kërkuar si diplomë në arkitekturë dhe kontratë pune. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, nga verifikimi i listëpagesave të shoqërisë “Llazo” sh.p.k. për periudhën Janar – Shtator 2018, rezulton se drejtuesi teknik arkitekt Z.D.K. nuk figuron në këto listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar. Pra ky operator ekonomik nuk plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në lidhje me drejtuesin teknik, një arkitekt, kështu që rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Llazo” sh.p.k. qëndron.

III.1.8. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k., Komisioni, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit në sistemin e prokurimit elektronik, konstaton se, operatori ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k., ka deklaruar se ka në stafin e tij të punësuar arkitekten Znj.B.S., ku nga verifikimi kjo e fundit figuron në licencën e shoqërisë si drejtuese teknike, dhe për të cilin është paraqitur dokumentacioni i kërkuar si diplomë në arkitekturë dhe kontratë pune ndërmjet saj dhe shoqërisë “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. Për sa i përket listëpagesave të shoqërisë “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. , nga verifikimi i tyre për periudhën Janar – Shtator 2018, rezulton se drejtuesi teknik arkitekt Znj.B.S. nuk figuron në këto listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar. Pra ky operator ekonomik nuk plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në lidhje me drejtuesin teknik, një arkitekt, kështu që rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. qëndron.

III.1.9. Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. Komisioni, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ky i fundit konstaton se, operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k., ka deklaruar se ka në stafin e tij të punësuar arkitektin Znj.M.M., ku nga verifikimi kjo e fundit figuron në licencën e shoqërisë si drejtuese teknike, dhe për të cilin është paraqitur dokumentacioni i kërkuar si diplomë në arkitekturë dhe kontratë pune ndërmjet saj dhe shoqërisë “Spektri” sh.p.k.. Gjithashtu, nga verifikimi i listëpagesave të shoqërisë “Spektri” sh.p.k., rezulton se drejtuesja teknike e kësaj shoqërisë Znj.M.M, figuron në këto listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor Janar – Shtator 2018. Pra operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k. plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, në lidhje me drejtuesin teknik, një arkitekt, kështu që rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Llazo” sh.p.k. dhe “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Colombo” sh.p.k. për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Llazo” sh.p.k. dhe “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, për sa kohë një nga pretendimet e ngritura për këta operatorë nga operatori ekonomik ankimues është pranuar dhe gjendja faktike e juridike e tyre do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke plotësuar kështu interesin e ligjshëm

të ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. me arsyetimin se “*Dst 2.2 pika 2. Kopje te vertetuar te bilanceve te vitit 2016 dhe 2017 te paraqitura prane Autoriteteve perkatese dhe i konfirmuar. Sipas informacioneve pasqyrat financiare te kesaj shoqerie jane jo te plota dhe mungon akt ekspertiza e ekspertit kontabel.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.2 “*Per kapacitetin ekonomik dhe financiar*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

- *Xhiroja mesatare vjetore per dy vitet e fundit (2016 dhe 2017) duhet të ketë një vlerë sa te pakten 50% e fondit limit qe prokurohet.*
- *Kopje të vërtetuar të bilanceve per vitin 2016 dhe 2017, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse dhe i konfirmuar.*
- *Vertetim per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2018 prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin.*

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Spektri” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 të certifikuara nga organet tatimore shoqëruar me Raportin e Audituesit të Pavarur
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2017 të certifikuara nga organet tatimore shoqëruar me Raportin e Audituesit të Pavarur

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c)gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. [...]*”

III.3.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin Publik*” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.3.5. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*”, neni 41, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara*

publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar; b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit; c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

III.3.6. Sa më sipër, Komisioni konstaton se në kriteret e veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesmarrës të paraqesin kopje të vërtetuara të bilanceve për vitin 2016 dhe 2017, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse dhe të konfirmuara. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se pasqyrat financiare të paraqitura nga operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k. janë jo të plota dhe mungon akt ekspertiza e ekspertit kontabël, KPP, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik, në përmbushje të kriterit të mësipërm, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2016 dhe 2017 të çertifikuara nga organet tatimore dhe të shoqëruara me Raportin e Audituesit të Pavarur, siç kërkohet nga autoriteti kontraktor. Pra, operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k. ka paraqitur bilancet e shoqërisë për vitet 2016, 2017 në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. me arsyetimin se “...Dst 2.3/2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 nje (Mjek) nderrmarje te punesuar, ne baze te paragrafit 12/2 te VKM Nr.692, date 06.11.2003. Nga informacionet tona Mjeku i kesaj shoqerie nuk figuron ne listepagesen e muajit Shtator 2018. Shoqeria Spektri shpk nuk ploteson kerkesen e mesiperme...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (nje) mjek ndërmarrjeje të punësuar, në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003. Kjo pike do të vërtetohet me paraqitjen e a) Licensës, b) Kontratës së Punës së mjekut, si dhe te jete i rregjistruar ne listepagesa per periudhen Janar –Shtator 2018.

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Spektri” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Kontratën e punës nr.rep. 378 nr.kol. 108, datë 04.03.2017 ndërmjet punëdhënësit shoqërisë “Spektri” sh.p.k. dhe punëmarrësit Z. M.S me profesion mjek.

- Diplomë nr.13981, "Master Shkencor në Mjekësi të Përgjithshme", në emër të z.M.S, lëshuar në datë 24.09.2012 nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë.
- Licencë për Ushtrimin Individual të Profesionit për Mjekë, datë 05.02.2013 në emër të Dr.M.S
- Listëpagesat e shoqërisë "Spektri" sh.p.k. për periudhën Janar-Shtator 2018.

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*"

III.4.4. Në nenin 26 "*Kontratat për punë publike*", pika 5, e VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar parashikohet se: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*".

III.4.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, përcaktohet: "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*"

a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt I kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*

b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën.*

ç) *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit. [...]*

III.4.6. Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë"* është përcaktuar:

"2/1. *Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të*

huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar.

2/3. Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi. Punëdhënësi e njej mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

[...]

"12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi."

[...]"

III.4.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.4.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të kenë në stafin e tyre një mjek, vërtetuar kjo me kontratën e punës dhe licencën e ushtrimit të profesionit, gjithashtu ky i fundit duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar – Shtator 2018.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Spektri" sh.p.k. në sistemin e prokurimit elektronik në përmbushje të kriterit të mësipërm, konstatohet se, shoqëria "Spektri" sh.p.k., ka të punësuar në stafin e tij mjekun z.M.S, duke paraqitur për këtë të fundit kontratën e punës, diplomën, licencën për ushtrimin e profesionit si dhe urdhrin e mjekut. Gjithashtu, nga verifikimi i listëpagesave të shoqërisë "Spektri" sh.p.k. për periudhën Janar – Shtator 2018, rezulton se Mjeku M.S. figuron në këto listëpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar. Pra ky operator ekonomik plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me mjekun, kështu që rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik "Spektri" sh.p.k. nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Colombo” sh.p.k. ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k. dhe BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & ”O.B Konstruksion” sh.p.k, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.5.1. Parashikimi i nenit 63, pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kërkohet shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Sa më sipër KPP gjykon se është e nevojshme të ndalet në elementët e testit të legjitimitimit në një procedurë ankimi përpara KPP. Këto elementë janë *interesi* i ankuesit, *dëmi real ose potencial i pritshëm* dhe ekzistenca e një vendimi të një autoriteti kontraktor *i marrë në kundërshtim me ligjin*.

III.5.2. Një ankimues do të konsiderohet i dëmtuar apo disavantazhuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshëm të vuajë personalisht një pasojë të ardhur drejtpërdrejtë nga veprimi i autoritetit kontraktor dhe kjo mund të kurohet (rregullohet) përmes ankimit në KPP. Gjithashtu, akti i pretenduar duhet të ketë ndodhur në hapësirën e të drejtave të tij ligjore në kuadrin e një procedure prokurimi publik.

III.5.3. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që, përmes ankimit në KPP, ai të fitojë kontratën. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë që pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Spektri” sh.p.k. nuk qëndrojnë, pasi ky i fundit përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Avduli” sh.p.k. dhe BOE “Ed Konstruksion” sh.p.k. & ”O.B Konstruksion” sh.p.k, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimesit nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Colombo” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-94207-11-14-2018, me objekt, “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Anastas Laska”, fshati Libofshë, Nj.A. Libofshë”, me fond limit 26.533.556 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 17.12.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Llazo” sh.p.k. dhe “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k. dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 90 Protokoli,
Datë 21.01.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

